
Lënda: Informacion i pjesshëm në lidhje me inspektimin e objektëve të finacuara nga Bashkia Tiranë për periudhën kohore nga viti 2012 deri në vitin 2018.

Objekti: **Ndertimi rrugës së Kosovarëve, Tiranë**

Investitori: **Bashkia Tiranë**

Vlera e Investimit: **86,065,547 lekë**

Periudha kohore: **Janar 2013 deri në Gusht 2013**

Inspektimi është kryer: **Dhjetor 2018**

Ky objekt është zbatuar në qytëtin e Tiranës në një segment të ri rrugor, pozicionuar në anën Veri-Lindore të zonës së fushave sportive të ish anëksit sportiv Dinamo. Segmenti rrugor nis nga bashkimi i rrugës "Kosovarëve", me rrugën "Kristo Luarasi" (segmenti rrugor para Digës së Liqenit Artificial) dhe përfundon në bashkimin e kësaj rruge me rrugën "Skënder Luarasi", me një gjatësi të përgjithshme rreth 550 m. Në momentin e investimit në këtë segment rrugor nuk ka qenë investuar më parë. Ka patur vetëm kalim traseje të saj shumë të ngushtë (nga vetë banorët e ndërtimeve përreth zonës) dhe ndërhyrja është bërë për ndërtim rruge të re, me të gjitha komponentët e saj.

Projekti ka ndërhyrë në ndërtimin e shtresave rrugore të trupit të rrugës (shtrimi me binder dhe shtrimin me asfalt), në ndërtimin e plotë të nënshtresave të trupit të rrugës me të gjitha komponentët e saj (stabilizanti, plus nënshtresat e tjera), në ndërtimin e rrjetit të ujrave të bardha dhe të zeza, në ndërtimin e tubacionit të ujit të pijshëm, në ndërtimin e plotë të trotuareve, plus rrjetin e ndricimit, në sinjalistikë rrugore, gjelbërim, etj. Projekti zbatimit ka parashikuar ndërtim të plotë të këtij segmenti rrugor. Punimet kanë filluar rreth muajit Janar të vitit 2013, e kanë përfunduar në muajin Korrik 2016. Zona ka filluar të ndërtohet kryesisht pas viteve 2000 dhe përfundimi i këtij segmenti rrugor ka qenë shumë i rëndësishëm për banorët e të gjithë zonës. Afati i përfundimit të garancisë së punimeve për objektin tashmë ka përfunduar (afati për këtë objekt ka qenë dy vjet). është kryer në favor të firmës zbatuese të punimeve edhe zhbllokimi i Garancisë së Punimeve prej 5 % të vlerës situacionit përfundimtar. Zbatimi i punimeve është bërë në kushte optimale, pasi pothuajse gjatë kohës së zbatimit të punimeve e gjithë rruga ka qenë e bllokuar, për kalimin e mjeteve motorike. Edhe pse objekti ka disa vite që është përfunduar cilësia e zërave kryesore të punimeve është në nivele të kënaqëshme. Sipas manualit të punimeve të ndërtimeve edhe pse garancia e punimeve zgjat vetëm dy vjet, jetëgjatësia e këtyre investimeve do duhet të shkojë për një periudhe kohore prej 7 deri në 10 vjet.

Nga pamja vizuale e objektit konstatohet se:

- Trupi i rrugës nuk rezulton të ketë ulje edhe pse vihen re në disa sektore të rrugës disa plasaritje të shtresave të asfaltit, por pa problematika të theksuara;
- Pllakat e trotuareve kanë vetëm disa ulje të vogla të pa konsiderueshme;
- Gjerësia e trotuareve është e njëtrajtëshme në të gjithë gjatësinë e rrugës;



Fig 1

Vihen re thyerje e plasaritje te pakta te pllakave te trotuareve;



Fig 2

Nuk janë respektuar sipas standartit të kërkuar lidhja e trotuareve me trupin e rrugës për personat me aftësi të kufizuar (në disa segmente ato pothuajse mungojnë).

- Pusetat janë vendosur në nivel të njëtrajtshëm me trupin e rrugës (me parete anësore të tyre të qëndrueshme dhe shumica prej tyre janë të pa lëvizshme);

-
- Nuk janë sistemuar me beton anësor kuadrati i trotuareve ku janë mbjellë pemët dekorative.

Objekti ka shtrirje të afatit kohor të zbatimit të tij, për një periudhë kohore prej më shumë se 2,5 vite, periudhë kjo e pa justifikuar për ndërtimin e një segmenti rrugor prej 550 metra. Rezulton se ndërtimi është bllokuar për shkak se trupi i rrugës kërkonte zgjerim të saj dhe institucionet shtetërore nuk janë marrë vesh midis tyre. Shkak ky jo i përligjur për këtë tipologji investimi shtetëror. Duhet të theksojmë senë vendin tonë akoma vijon të ndërtohet pa leje (investime shtetërore), me mendimin se ne jemi shteti dhe mund të bëjmë si të duam. Nëse objekti do kishte leje ndërtimi qe para fillimit të punimeve, atëhere zbatimi për përfundimin e tij nuk do ti kalonte 5-6 muaj. Për objektin ka përfunduar Garancia e punimeve dhe rezulton se rruga është në kushte mesatarisht të kënaqshme.

Konkluzione në lidhje me objektin.

- *Të bëhet riparimi i pllakave të parapërgatitura të trotuareve, duke zëvendësuar të gjitha pllakat e thyera apo dëmtuara në to.*
- *Të ribehen dhe riparohen të gjitha kalimet për personat me aftësi të kufizuar të trotuareve, me lidhje të njëtrajtëshme me trupin e rrugës, e pa pengesa.*
- *Ndërhyrja e kryer në trotuarin Perëndimor të kësaj rruge për korsinë e dedikuar të bicikletave, është bërë jo cilësor. Vihen re thyerje e plasaritje të shtresës së betonit të derdhur. Për mendimin tim ndërtimi i kësaj shtrese betoni dhe prishja e pllakave të trotuarit, është kryer pa një studim të mirëfilltë fizibiliteti (nuk ka studim kosto përfitim).*
- *Të sistemohen kuadratët ku janë mbjellë pemët dekorative për të mos lejuar prishjen e mëtejshëm të trotuareve të rrugës.*
- *Sipas mendimit tonë objekti i ka rezistuar afatit kohor të ndërtimit të tij dhe se riparimet për përmiresimin e kesaj rruge janë shumë të vogla.*

Per të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarte të kontratave të zbatimit të punimeve, si dhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr 3, Datë 15.01.2001, Nr 2, datë 13.05.2005 dhe Nr 1, datë 16.06.2011, "Për mbikqyrjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".